



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.183/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesues Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Koalicioni Për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohen të bazuara ankesat e Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova) me seli në Prishtinë, Anr.183/2025, e datës 24.01.2025 dhe Anr.196/2025, e datës 25.01.2025.

II. Subjektit politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 7000 (shtatë mijë) euro.

III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 24.01.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.183/2025 nga Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova) me seli në Prishtinë, në të cilën ka theksuar se në një reagim publik në rrjetin facebook të datës 23.01.2025, kandidati për deputet nga subjekti politik Koalicioni për Familje, Eman Rrahmani në postimin e tij publik ka deklaruar "Nuk ka martesë burrë me burrë, nuk ka martesë grua me grua. Kushdo që kështu i

mëson fëmijët tanë, turp ju qoftë!”. Po ashtu ne një reagim publik ne rrjetin social facebook te datës 23.01.2025 kandidatja për deputete nga subjekti politik Koalicioni për Familje Laureta Rexha ne postimin e saj ne publik ka deklaruar *“Rikujtojmë qytetaret se nisma jone nuk synon dhunën ndaj tyre si komunitet ne asnjë forme, por mbrojtja e dinjitetit tone njerëzor dhe vazhdimësisë se jetës si dhe te ardhmes se fëmijëve tanë nga degjenerimi dhe prishja jone kryqe per një shoqëri te shëndoshë dhe te suksesshme ne kuptimin e plote te fjalës”*

Edhe kandidati për deputet nga i njëjti subjekt politik Asdren Bytyqi përmes një video qe e ka postuar ne profilin e tij ne facebook me date 23.01.2025 ka deklaruar se “Nga sot liria e shprehjes ndryshoi ne Kosove. PZAP dënoi koalicionin për familjen me 4500 euro, për shkak te ankesës se parashtruar nga një OJQ “Dylberizem” qe mbron te drejtat e komunitetit LGBT me pretendimin se ne garën zgjedhore kandidatet tanë po përdorin “ fjale diskriminuese” dhe “gjuhe te urrejtjes” për shkak se po i premtojmë popullit se nuk do te lejojmë martesat e gjinisë se njëjtë, nuk do të lejojmë adaptimin e fëmijëve nga homoseksualet, se nuk do te lejojmë ndryshimin e gjinisë dhe shume anomali tjera sociale”.

Parashtruesi i ankesës thekson se përdorimi i frazës “nga degjenerimi dhe prishja” ne këtë kontekst stigmatizon mësimin e fëmijëve për barazi gjinore dhe te drejtat e komunitetit LGBTI- duke i pozicionuar këta persona si te degjeneruar dhe te prishur njekosisht rrezik për shoqërinë e shëndoshë kosovare, dhe kjo paraqet sipas parashtruesit te ankesës gjuhe diskriminuese dhe fyese. Po ashtu parashtruesi i ankesës thekson se përdorimi i frazës si dhe shprehja “ anomali tjera sociale” për te ju referuar martesave te gjinisë se njëjtë, ndryshimit të gjinisë, ndryshimit te gjinisë, adoptimit te fëmijëve nga LGBT+ përbënë gjuhe diskriminuese dhe fyese e cila shkel standardet ligjore dhe etike dhe gjithashtu nxite përçarje dhe frike ne shoqëri.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur linqet <https://ëëë.facebook.com/share/p/15fjMF43ee/>

<https://ëëë.facebook.com/share/p/19obfdU61E/>

<https://ëëë.facebook.com/share/p/15fYxutq7X/>

<https://ëëë.facebook.com/reel/3973860986203897>

Me datë 25.01.2025, PZAP ka pranuar ankesën Anr.196/2025 nga Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova) me seli në Prishtinë, në të cilën ka theksuar se në tubimin e mbajtur më 24 janar 2025 në Gjilan, Koalicioni për Familje, ka nxitur urrejtje e përçarje në drejtim të komunitetit LGBT+, duke përdorur terme denigruese që bien ndesh me respektin për tolerancën, mjedisin demokratik zgjedhor e sundimit të ligjit dhe legjislacionin zgjedhor në fuqi. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se kandidati Eman Rrahmani ka nxitur përçarjen e shoqërisë kosovare, ku personat LGBTI+ dhe mbështetësit e tyre potencial i ka paraqitur kundër shtetit dhe kundër qytetarëve te Republikës se Kosovës duke theksuar *“ Andaj qytetaret duhet ti japin vlerësimin te gjithë atyre te cilët kane mashtruar dhe po mashtrojnë ne secilën fushate zgjedhore edhe angazhimin e tyre politik pastaj kur te marrin pushtetin e bojne per krejt grupet te cilat janë kundër interesave te qytetarëve te Republikës se Kosovës, janë kundër interesave te vendit tone, kombit tone dhe te shoqërisë tonë”*

Po ashtu te njëjtë theksojnë se kandidati për deputet nga ky subjekt politik Jeton Haxhimustafa, ne postimin e tij publik ka deklaruar *“Kujtoni përgjegjësinë që do t’ia kaloni partisë që do ta votoni dhe dëmin që mund të shkaktoj për të ardhmen e tyre me dukuri degjeneruese që iu servohen”*.

Parashtruesi i ankesës thekson se kandidatet e këtij subjekti politik kanë treguar shpërfillje e paragjykim në raport me vendimin e PZAP-së, duke shkuar kundër parimeve të atmosferës zgjedhore paqësore dhe të respektit për sundimin e ligjit dhe ka kërkuar nga PZAP që, të konstatojë shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet nga Koalicioni për Familje dhe kandidatët Eman Rrahmani, Fatmir Smajli, Ferid Agani dhe Jeton Haxhimustafa dhe të e sanksionojë maksimalisht Koalicionin për Familje dhe kandidatët për përdorimin e gjuhës nxitëse dhe diskriminuese, të kërkojë publikisht nga Koalicioni për Familje që të tërheqë deklaratat diskriminuese dhe të kërkojë fale publike ndaj komunitetit LGBTI+, si dhe të sigurohet që subjektet politike respektojnë standartet demokratike dhe ligjet në fuqi gjatë fushatës zgjedhore.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur deklaratat e Ferid Agani, Fatmir Smajli, Eman Rrahmani dhe postimin e kandidatit Jeton Haxhimustafa.

Më tutje parashtruesi i ankesës ka kërkuar në PZAP, që të konstatojë shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet nga Koalicioni për Familje dhe kandidatët Eman Rrahmani, Visar Korenica, Laureta Rexha dhe Asdre Bytyqi, të ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj Koalicionit për Familje dhe kandidatëve për përdorimin e gjuhës nxitëse dhe diskriminuese dhe të kërkojë publikisht nga Koalicioni për Familje që të tërheqë deklaratat diskriminuese dhe të kërkojë fale publike ndaj komunitetit LGBTI+, si dhe të sigurohet që subjektet politike të respektojnë standartet demokratike dhe ligjet në fuqi gjatë fushatës zgjedhore.

PZAP, me datë 25.01.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje Koalicionit për Familje, lidhur me ankesën Anr.183/02025 të parashtruar nga ankuesi Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjimore (CEL Kosova), ndërsa me datë 26.01.2025 PZAP i është drejtuar me kërkesë për përgjigje Koalicionit për Familje lidhur me ankesën Anr.196/2025 të parashtruar nga ankuesi Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjimore (CEL Kosova), mirëpo Subjekti Politik Koalicioni për Familje, nuk është përgjigjur as në afatin e paraparë deri më datë 27.01.2025, e as më pas.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosijs së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.183/2025, dhe A.nr.196/2025 janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.183/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga e njëjta organizta kundër te njëjtë politik Koalicioni për Familjen, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se ankesat janë të bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, të cilat janë bërë nga Koalicioni për Familjen, respektivisht nga kandidatët për deputet ku shihet se janë përdorë shprehjet si : *“turp ju qoft”*, pastaj *“mbrojtja e dinjitetit tonë njerëzor dhe vazhdimësisë së jetës, si të ardhmen e fëmijëve tanë nga degenerimi dhe prishja”*, *anomolit sociale si dhe dukuri Gjeneruese*” vlerëson se përdorimi i gjuhës së tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga subjekti politik Koalicioni për Familjen, përkatësisht, nga kandidatët për deputet të këtij subjekti, ndaj LGBTI+ në rrjetin sociale Facebook, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është përdorur gjuha ndaj një komuniteti, faktin që deklaratat janë publikuar në rrjetin social Facebook, prandaj sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese. Përdorimi i termave si "degeneruese" dhe sugjerimi i ndikimeve të mundshme negative për të ardhmen e fëmijëve, mund të shkaktojë reagime të kundërta dhe të krijojë ndarje, për shkak të përmbajtjes së tij, që mund të interpretohet si një fushatë e bazuar në frikë dhe paragjykim. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse, andaj sipas Panelit përdorimi i kësaj gjuhe nga kandidatët për deputet është shkelur etika zgjedhore dhe standardet e sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se fjalitë e përdora i referohen grupeve të caktuara dhe si të tilla përmbajnë elemente të nxitjes së urrejtjes, diskriminimi dhe cenim të drejtave të grupeve që u është referuar.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje përkatësisht faktin se i njëjti subjekt edhe dy raste të mëhershme në këtë fushatë zgjedhore është dënuar për përdorim të gjuhës së urrejtjes,

por përkundër kësaj ka vazhduar me përsëritjen e shkeljes. Në larësin e gjobës paneli ka marr për bazë faktin se subjekti politikë në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11), nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr.183/2025, datë 27.01.2025

Kryesues i Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.28/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Beshir Islami dhe Rustem Thaqi, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës të Subjektit Politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.183/25 të datës 27.01.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 03.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet si e themeltë ankesa e Subjektit Politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, Ndryshohet Vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.183/2025 i datës 27.01.2025, dhe vendoset ashtu që: Refuzohen të pathemelta ankesat e Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova), me seli në Prishtinë, A.nr.183/2025 e datës 24.01.2025 dhe A.nr.196/2025 e datës 25.01.2025.

A r s y e t i m

Me pjesën e I të dispozitivit të vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.183/2025 të datës 27.01.2025, është vendosur: pranohen si të bazuara ankesat e



Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova), me seli në Prishtinë, A.nr.183/25 datë 24.01.2025 dhe A.nr.196/2025 datë 25.01.2025. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, Subjekti Politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së kodit për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 7000 €. Me pjesën e III të dispozitivit, detyrohet Subjekti Politik Koalicioni për Familje, që gjobën e shqiptuar si në pikën II të dispozitivit, ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

Kundër vendimit të sipërpërmendur të PZAP, Subjekti Politik Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, me kohë ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, nëpërmjet të cilës e kundërshton ligjshmërinë e vendimit të lartcekur, se ky vendim nuk është në pajtim me parimet Kushtetuese dhe ligjore ndërkombëtare, veçanërisht nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), me propozim që të aprovohet ankesa dhe të anulohet gjoba e vendosur ndaj Koalicionit për Familjen, të rikonfirmohet rëndësia e lirisë së shprehjes në nxitjen e debatit demoikratik, dhe të njihen deklaratat e Koalicionit si shprehje e mbrojtur politike sipas nenit 10 të KEDNJ-së.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, përmes të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës , vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa e subjektit politik Koalicioni për Familje, është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i, më datë 24.01.2025 ka pranuar ankesën AA.nr.183/2025 nga Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova), me seli në Prishtinë, në të cilën ka theksuar se në një reagim publik në rrjetin facebook të datës 23.01.2025, kandidati për Deputet Eman Rrahmani në postimin e tij publik ka deklaruar “ Nuk ka martesë burrë me burrë, nuk ka martesë grua me grua. Kushdo që kështu i mëson fëmijët tanë turp ju qoftë”. Po ashtu, në një reagim publik në rrjetin social facebook të datës 23.01.2025, kandidatja për deputete nga ky Koalicion Laureta Rexha, në postimin e saj në publik ka deklaruar “Rikujtojmë qytetarët se nisma jonë nuk synon dhunën ndaj tyre si komunitet në asnjë formë, por



mbrojtja e dinjitetit tonë njerëzor dhe vazhdimësisë së jetës të ardhmes së fëmijëve tanë nga degjenerimi dhe prishja “, pastaj përdorimi i termave dhe gjuhës së tillë, si “anomali sociale dhe dukuri degjeneruese”. Edhe kandidati për deputet nga i njëjti subjekt politik Asdren Bytyqi përmes një video që e ka postuar në profilin e tij në facebook më datë 23.01.2025 ka deklaruar se “ Nga sot liria e shprehjes ndryshoi në Kosovë. PZAP dënoi Koalicionin për Familjen me 4500 €, për shkak të ankesës së parashtruar nga një OJQ “Dylberizim” që mbron të drejtat e komunitetit LGBT me pretendimin se në garën zgjedhore kandidatët tanë përdorin “ fjalë diskriminuese” dhe “ gjuhë të urrejtjes” për shkak se po i premtojnë popullit se nuk do të lejojmë martesat e gjinisë së njëjtë, nuk do të lejojmë adoptimin e fëmijëve nga homoseksualët, se nuk do të lejojmë ndryshimin e gjinisë dhe shumë anomali tjera sociale”. Parashtruesi i ankesës thekson se përdorimi i frazës “nga degjenerimi dhe prishja” në këtë kontekst stigmatizon mësimin e fëmijëve për barazi gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBT duke i pozicionuar këta persona si të degjeneruar dhe të prishur njëkohësisht rrezik për shoqërinë e shëndosh Kosovare dhe kjo paraqet sipas parashtruesit të ankesës, gjuhë diskriminuese dhe fyese. Po ashtu edhe përdorimi i frazës si dhe shprehja “anomali tjera sociale” për të ju referuar martesave të gjinisë së njëjtë, ndryshimit të gjinisë, adoptimit të fëmijëve nga LGBT + përbën gjuhë diskriminuese dhe fyese e cila shkel standardet ligjore dhe etike dhe gjithashtu nxitë përçarje dhe frikë në shoqëri. Si provë në ankesë ka bashkangjitur linqet <https://www.facebook.com/share/p/15fjMF43ee/>, si në shkruesat e lëndës.

Më datën 25.01.2025 PZAP, ka pranuar ankesën A.nr.196/2025 nga Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova), me seli në Prishtinë, ku ka theksuar se në tubimin e mbajtur më datë 24.01.2025, në Gjilan, Koalicioni për Familjen ka nxitur urrejtje e përçarje në drejtim të komunitetit LGBT +, duke përdorur terme denigruese që bien ndesh me respektin për tolerancën, mjedisin demokratik zgjedhor e sundimin e ligjit dhe legjislacionin zgjedhor në fuqi. Më tej, ka theksuar se kandidati Eman Rrahmani ka nxitur përçarjen e shoqërisë Kosovare, ku personat LGBT + dhe mbështetësit e tyre potencial i ka paraqitur kundër shtetit dhe kundër qytetarëve të Republikës së Kosovës duke theksuar “ Andaj qytetarët duhet ti japin vlerësimin të gjithë atyre të cilët kanë mashtruar dhe po mashtrojnë në secilën fushatë zgjedhore edhe angazhimin e tyre politik pastaj kur të marrin pushtetin e bojnë për krejt grupet të cilat janë kundër interesave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, janë kundër interesave të vendit tonë, kombit tonë dhe të shoqërisë tonë”. Të njëjtit theksojnë më tej, se kandidati për deputet nga ky subjekt politik, Jeton Haxhimustafa, në postimin e tij publik ka deklaruar “ Kujtoni përgjegjësinë



që do t'ia kaloni partisë që do ta votoni dhe dëmin që mund të shkaktojë për të ardhmen e tyre me dukuri degjeneruese që iu servohen”. Parashtruesi i ankesës thekson se kandidatët e këtij subjekti politik kanë treguar shpërfillje e paragjykim në raport me vendimin e PZAP-së, duke shkuar kundër parimeve të atmosferës zgjedhore paqësore dhe të respektit për sundimin e ligjit dhe ka kërkuar nga PZAP që të konstatojë shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nga Koalicioni për Familje dhe kandidatët Eman Rrahmani, Fatmir Ismajli, Ferid Agani, dhe Jeton Haxhimustafa dhe të sanksionojë këtë Koalicion për Familjen dhe kandidatët për përdorimin e gjuhës nxitëse dhe diskriminuese dhe që të sigurohet që subjektet politike të respektojnë standardet demokratike dhe ligjet në fuqi gjatë fushatës zgjedhore, të kërkojë falje publike nga LGBT dhe të tërheq deklaratat diskriminuese dhe si provë ka bashkangjitur postimin dhe deklaratat e të sipër përmendurve.

PZAP, më datë 25.01.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje Koalicionit për Familje, lidhur me ankesën e parë, dhe më datë 26.02.2025, lidhur me ankesën e dytë, të sipër përmendura, por subjekti politik Koalicioni për Familje nuk është përgjigjur. PZAP, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, i ka bashkuar ankesat, duke i trajtuar me një vendim, konform nenit 84 par.1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shikimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se nga të njëjtat shihet se janë përdorë shprehjet si: “ turp ju qoftë”, pastaj “ mbrojtja e dinjitetit tonë njerëzor dhe vazhdimësisë së jetës, si të ardhmen e fëmijëve tanë nga degjenerimi dhe prishja”, “anomali sociale si dhe dukuri degjeneruese”, vlerëson se përdorimi i gjuhës së tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11 të LZP-së, me të cilën përcaktohet, “Gjatë periudhës së fushatës subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: (1.11), përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdor fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”. Ndërsa, PZAP konstaton se Kodi i Mirësjelljes, i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët anëtarët e subjekteve politike dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këto Kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Ndaj, PZAP, gjeti se gjuha e përdorur nga subjekti politik Koalicioni për Familje, përkatësisht nga



kandidatët për deputet të këtij subjekti, ndaj LGBT + në rrjetin social Facebook, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11, të LZP-së, ku janë përcaktuar veprimet e ndaluara të subjekteve politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është përdorur gjuha ndaj një komuniteti, faktin se deklaratat janë publikuar në rrjetin social Facebook, prandaj sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese. Përdorimi i termave si “degjeneruese” dhe sugjerimi i ndikimeve të mundshme negative për të ardhmen e fëmijëve, mund të shkaktojë reagime të kundërta dhe të krijojë ndarje, për shkak të përmbajtjes së tij, që mund të interpretohet si një fushatë e bazuar në frikë dhe paragjykim. Rregullat zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse, andaj, sipas Panelit, përdorimi i kësaj gjuhe nga kandidatët për deputet shkel etikën zgjedhore dhe standardet e sjelljes në fushatë zgjedhore, e cila minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta.

PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se fjalitë e përdora i referohen grupeve të caktuara dhe si të tilla përmbajnë elemente të nxitjes së urrejtjes, diskriminimit dhe cenim i të drejtave të grupeve që u është referuar. PZAP, po ashtu, lidhur me lartësinë e gjobës si në dispozitiv të vendimit, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje përkatësisht faktin se i njëjti subjekt edhe dy raste të mëhershme në këtë fushatë zgjedhore është dënuar për përdorim të gjuhës së urrejtjes por përkundër kësaj ka vazhduar me përsëritjen e shkeljes. Në lartësinë e gjobës Paneli ka marrë për bazë faktin se subjekti politik në fjalë, nuk është përfitues i Fondit për Financimin e Subjekteve Politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës, prandaj, në kuptim të dispozitave të nenit 34 pika 1.11, nenit 118 par.1, nenit 120 par.1, nënp.1.3 të LZP-së, ka vendosur si në dispozitiv të vendimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP, lidhur me aprovimin e ankesave të parashtruara nga



Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova), pasi që vendimi i PZAP-së, është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke i e aprovuar në tërësi ankesat e parashtruara nga Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova), duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të vendimit të PZAP-së për arsye se:

Me provat që gjenden në shkresat e lëndës, ankesa së bashku me dëshmitë e ofruara të paraqitura në PZAP, dhe ankesa drejtuar kësaj gjykate, si dhe provat tjera të administruara, shihet qartë se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: “1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës konkretisht dëshmitë e ofruara me ankesë shihet se kandidatët për deputetët të subjektit politik Koalicioni Për Familje, përkatësisht kandidatët për deputet Eman Rrahmani dhe Visar Korenica në rrjete sociale kanë postuar se: “Po tentojnë të na mbyllin gojën, por ne me zemra flasim. Po na gjobitin për të na frikësuar, por neve veç trimërinë na e shtojnë. Po e përsëris prapë edhe më fuqishëm atë që për të u dënuam: Nuk ka martesë burrë me burrë, nuk ka martesë grua me grua. Kushdo që kështu i mëson fëmijët tanë, turp ju qoftë!”

Laureta Rexha: në rrjete sociale ka postuar se: “Të nderuar qytetarë, Koalicioni për Familjen ka pranuar një gjobë prej disa mijëra eurosh për shkak të shfaqjes së ideve tona konservatore lidhur me moslejimin e ligjit konform martesave të komunitetit LGBTI+ dhe sipas tyre, gjuhës së urrejtjes (hate speech), inicuar nga organizata Dylberizëm. Rikujtojmë qytetarët se nisma jonë nuk synon dhunën ndaj tyre si komunitet në asnjë formë, por mbrojtja e dinjitetit tonë njerëzor dhe vazhdimësisë së jetës, si dhe të ardhmes së fëmijëve tanë nga degjenerimi dhe prishja e kësaj kyçe



për një shoqëri të shëndoshë dhe të suksesshme në kuptimin e plotë të fjalës. Prandaj, ftojme qytetarët që ta mbështesin masivisht kauzën tonë për mbrojtjen e familjes sa është koha, dhe mos të lejojmë nisma që nuk përkojnë me etikën dhe kulturën tonë kombëtare as shpirtërore të na cenojnë idealet tona më të shenjta. Heshtja nuk është zgjidhje. Inferioriteti dhe mbyllja e syve nuk është zgjidhje po ashtu.

Asdren Bytyqi: në rrjete sociale ka postuar se: “Nga sot, liria e shprehjes ndryshoi në Kosovë. PZAP dënoj Koalicionin për Familje me 4500 €, për shkak të ankesës së parashtruar nga një OJQ “Dylberizëm” që mbron të drejtat e komunitetit LGBT me pretendimin se në garën zgjedhore kandidatët tonë po përdorin “fjalë diskriminuese” dhe “gjuhë të urrejtjes” për shkak se po i premtojmë popullit se nuk do të lejojmë martesat e gjinisë së njëjtë, nuk do të lejojmë adoptimin e fëmijëve nga homoseksualët, se nuk do të lejojmë ndryshimin e gjinisë dhe shumë anomali tjera sociale.”

Nga deklaratat e lartcekura Gjykata Supreme erdhi në përfundim se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11, të LZP-së. Postimet e lartcekura dhe fjalët të cilat janë përdorur në këto postime nuk përmbajnë fjalor që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve. Përmes këtyre postimeve kandidatët në fjalë shpalosin programin e tyre dhe kërkojnë mbështetjen duke ofruar atë që kanë në plan program gjatë fushatës zgjedhore, ndërsa fjalët të përdorua këtu nuk janë të drejtuara kundrejt një subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar, në atë mënyrë që të ngjall apo nxit urrejtje ndaj tyre. Në këto postime në asnjë moment nuk ka thirrje apo nxitje që të ndërmerren veprime të caktuara kundër këtyre subjekteve, madje në postime shprehet fakti duke theksuar se “rikujtojmë qytetarët se nisma jonë nuk synon dhunën ndaj tyre si komunitet në asnjë formë”, ndërsa fjalët “Nuk ka martesa burrë me burrë, nuk ka martesa grua me grua, kushdo që kështu i mëson fëmijët tanë, turp ju qoftë”, nuk mund të konsiderohen si nxitje e urrejtjes, nga kjo rezulton se nuk po kërkohet nga qytetarët që të ndërmerret ndonjë veprim i caktuar kundër tyre, mirëpo këto kanë të bëjnë me zotimet në fushatë zgjedhore se nuk do ti lejojnë nismat legislative sa i përket këtij komuniteti përmes veprimit demokratik, prandaj dhe pse këto qëndrime nuk i shkojnë përshtati ndonjë subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar, dhe shtu faktin se të njëjtat fjalime



nuk i drejtohen qytetarëve për nxitje të urrejtjes apo me kërkesë që ndaj tyre të ndërmerret ndonjë veprim i caktuar, dhe nuk ka ndonjë veprim apo fjalë e cila fyen apo ofendon të njëjtit, nuk mund të konsiderohen si nxitje e urrejtjes dhe shkelje e kodit të mirësjelljes, prandaj, nga këtu, rezulton se nga ankesat e parashtruara nga Organizata Joqeveritare Dylberizim dhe Qendra për Barazi Gjinore (CEL Kosova), me seli në Prishtinë, nuk është provuar katërcipërisht shkelja e pretenduar, ndaj, si të tilla, të njëjtat janë të pa themelta.

Gjykata Supreme vlerëson se duhet të sqarohet fakti se, sikundër që nuk mund të ndalohen të drejtat e një subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar që në mënyrë të lirshme ti shpreh bindjet e tyre dhe veprimtarinë e saj, poashtu nuk mund të sanksionohet një subjekt politik i cili mban qëndrim të kundërt kundrejt tyre, pa pasur ndonjë element të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Që të vie në shprehje shqiptimi i gjobës duhet të vërtetohet fakti se i njëjti subjekt me veprimet, apo fjalimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore, nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve. Prandaj në këtë rast PZAP, nuk ka arritur të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike dhe nuk e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk rezulton se kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, prandaj ankesa e subjektit politik është aprovuar si e bazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është ndryshuar.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, dhe 34 paragrafi 1 pika 1.11, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr.28/2025 datë 03.02.2025.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

Kryetar i kolegjit,
Mr.Sc.Muhamet Rexha



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-28/2025

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqijt, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____

Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT GJYKIM 03.02
2025

Numri i shtojcave: _____

broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

05.02.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioča ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

ORA:
11:14

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analiahet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkakun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.